

Homoseksualizmi – orientim seksual e jo sëmundje

Homoseksualizmi është orientim seksual drejt personave të së njejtës gjini. Një pjesë e popullatës ka orientim krejtësisht homoseksual, ndërsa një pjesë homo dhe heteroseksual.

Egzistojnë persona tek të cilët, sjellja homoseksuale paraqitet vetëm atëherë kur nuk kanë mundësi për marrëdhënie heteroseksuale. Homoseksualizmi është i fshirë nga lista e diagnozave psikiatrike. Kjo nuk paraqet sjellje devijante dhe trajtohet si orientim seksual, heteroseksualizëm, biseksualizëm, homoseksualizëm. Orientimi seksual është tërheqje erotike, që individi e ndjenë (emocionim për persona të të njejtës gjini, të gjinisë së kundërt ose të të dyjave gjini).

Çfarë paraqet jeta seksuale e një njeriu homo apo heteroseksual?

Përjetim shpirtëror dhe kënaqësi emocionale, me person të gjinisë së kundërt që me vete mbanë reproduksion, të njejtat ndjenja janë prezente edhe te marrëdhëniet homoseksuale mirëpo nuk ka vazhdim të llojit.

A ndikon orientimi seksual mbi paraqitjen e disfunktionimeve seksuale?

Disfunktionet seksuale që i trajton psikiatria njësoj mund të paraqiten si te hetero, poashtu edhe te homo dhe biseksualët.

Si ndjehet një person me orientim homoseksual në lidhje intime me person të gjinisë së kundërt?

Thjesht thënë, si një individ me orientim heteroseksual me një individ të të njejtës gjini, definitivisht jokëndshëm, burim i shumë pakënaqësive, promiskuitet (ndërrim i partnereve) por asnjera nuk është mjaft e mirë, fshehje pas martesave heteroseksuale, reproduksionit dhe lëndim të partnerit heteroseksual me interes joautentik për te.

Çfarë është orientimi seksual te të miturit?

Krejtësisht josinguri e zakonshme e të miturit për orientimin seksual të tij/saj, jo të sigurtë se a kanë orientim homo, hetero apo biseksual, mirëpo në këtë periudhë flasim për formimin e të njejtës, ashtuqë çfarëdo kurioziteti homoseksual nuk do të thotë edhe orientim homoseksual. Numri më i madhë i të miturve diku rreth 84% do të gjejnë kënaqësinë e tyre seksuale me person të gjinisë së kundërt, mirëpo sigurisht se nuk duhet të nxisim homofobi dhe assesi të promovojmë homoseksualizëm, sepse periudha turbulluese e të miturve është periudhë e zgjedhjeve.

A janë fazat seksuale nëpër të cilat kalojnë partnerët heteroseksualë dhe homoseksualë të ngjajshme?

Plotësisht të ngjajshme.

Cila është pasoja e paraqitjes së promiskuitetit homo dhe heteroseksual dhe ku është më i shpeshtë?

Promiskuiteti është pjesë e nevojave të pakënaqshme seksuale dhe emocionale tek individi, është prezente edhe te homo edhe te heteroseksualët, posaçërisht është impresionues te homoseksualizmi latent (mashkullor), duke kërkuar partnerin e vërtetë

dhe duke mospranuar orientimin seksual personal, për të qenë socialisht të pranueshëm do të ndërrojnë shumë femra mirëpo asnjera nuk do të jetë ajo e vërteta. Prandaj kemi aq shumë martesë të shkatëruara, femi me vese të vërteta dhe të lënë pas dore në mënyrë kaotike, për arsye se dikush nuk ka mund të pranohet dhe të jetë i pranuar, pa paragjykimet se është homoseksual dhe në këtë rast vijnë disfunksionet seksuale, impotencia, ejakulimi i parakohshëm, mungesa e dëshirës dhe ndërrimi i partnereve.

A egziston lidhje mes marrëdhënieve anale heteroseksuale dhe tendencave homoseksuale?

Absolutisht jo, zona anale është zonë erogjene si gjatë marrëdhënieve homo poashtu edhe atyre heteroseksuale.

Lojrat e të miturve të të njëjtës gjini a kanë ndikim mbi orientimin drejt homoseksualizmit?

Zakonisht jo, ajo është vetëm një fazë kalimtare.

A mundet kontaktet homoseksuale dhe homoerotike të të miturve të paraqesin paralajmërim se ai person në jetën e tij do të homoseksualisht i orientuar?

Nëse nuk bëhet fjalë për abuzim dhe e njëjta rrëfëhet me psikolog dhe psikiatër, jo.

Çfarë është homoseksualizmi e çfarë janë ndjenjat homoerotike pa realizim gjatë sjelljes homoseksuale?

Ndjenjat homoerotike mund të jenë fantastikisht prezente, mirëpo asnjëherë të realizueshme, nëse janë pjesë e një homoseksualizmi latent në moshën e rritur shkohet në pranimin e të njëjtave.

Përse disa individ me orientim homoseksual mbajnë edhe lidhje heteroseksuale, duke u eksponuar para publikut?

Trendi i heteroseksualizmit dhe stigma e homoseksualizmit, jopranimi social dhe ai familjar definitivisht e bëjnë të veten, mirëpo njëherit edhe mosgatishmëria e individit për ta pranuar orientimin e vet seksual.

A egzistojnë dallime në pamjen fizike, koncentrimin e hormoneve në mes homo dhe heteroseksualëve?

Jo, feminizimi dhe maskulizimi nuk nënkupton homoseksualizëm dhe të kundërtën, nuk egzistojnë dallime hormonale, në kuadër të orientimit seksual, por mund të jenë prezente në kuadër të çrregullimeve tjera endokronologjike.

Cilat janë dallimet mes homoseksualëve femrorë dhe mashkullorë në relacion me kontaktet e përgjithshme sociale me individë të gjinisë së kundërt?

Homoseksualizmi femrorë socialisht është më i pranueshëm, edhe njëherit edhe tjerët janë plotësisht të njëjtë, nëse i largojmë paragjykimet e personave homofobik atëherë vijmë në përfundim se orientimi seksual nuk ka kurrfarë ndikimi në relacionet ndërnjerëzore.

Zakonisht cilat janë e reaksionet e prindërve heteroseksualë nëse fëmijt janë homoseksualisht të orientuar?

Në të shumtën e rasteve mosparnim, flasim për fëmijt që gjenden në periudhën post-adolshente, me orientim seksual të formuar, nuk guxojmë ta minimizojmë problemin e prindërve sepse edhe ata kalojnë në një fazë të pranimi të një gjëje që sipas orientimit të tyre heteroseksual është diçka e huaj, mirëpo mos të harrojmë se dashuria e vetme e pakompromisshme është ajo e prindërve dhe le të jetë si e tillë.

Kur definitivisht formohet orientimi seksual (ata të cilët janë krejtësisht homoseksualisht të orientuar) dhe kur te femrat homoseksuale, çfarë ndodhë me biseksualët?

Për formimin definitiv të orientimit seksual flasim në periudhën post-adolshente, mirëpo fillat e saj mund të datojnë prej periudhës së hershme adoleshente dhe gjatë adoleshencës. Çfarë është relacioni i heteroseksualëve ndaj homoseksualëve në mesin tonë?...

Individual, në mes dy ekstremeve, pranimi pa paragjykime dhe homofobi, me shumë pyetje se si ka ardhur deri te kjo???

Nëse nisemi me qëndrim që përmbanë paragjykime ndaj tjerëve, kuptimi ynë për ta dhe komunikimi me ta bëhet më pak i efikasshëm. Nëse egyistojnë paragjykime për një grup njerëzish, të cilët sipas orientimit të tyre seksual dallojnë prej heteroseksualëve, përmes të cilëve vazhdon lloji, shumë është e mundshme që ata njerëz të ndjehen të diskriminuar. Është e zakonshme që paragjykimet të përforcohen, nëse lexohen apo dëgjohen vetëm ato informata që janë në përputhshmëri me paragjykimet.

Pranimi i dallimeve në orientimin seksual është pranimi i individualizmit të huaj dhe atij personal, dhe kjo paraqet një virtet të lartë njerëzor.

Prof.Dr.Viktorija Vujović

psikiatër-psikoterapeut

Sekretare e asociacionit të psikiatërve të Maqedonisë